

ANALIZË E SHKURTË  
**Planifikim urban për qytetarët**  
*Shtator 2013, Prizren*

## PËRMBAJTJA

I. Hyrje .....	2
II. Koncepti i qytetit gjithëpërfshirës .....	3
III. Projekti për planifikimin me pjesëmarrje .....	5
IV. Metodologjia .....	6
V. Rezultatet .....	7
VI. Konkludim .....	14
EC Ma Ndryshe .....	16

Ky publikim është pjesë e projektit "QYTETI GJITHËPËRFSHIRËS – Planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren", i përpratur financiarisht nga Olof Palme International Center që përkrahet nga Qeveria e Suedisë. Përmbajtja e këtij publikimi pasqyron opinionet e autorit dhe jo domosdoshmërisht opinionet e Olof Palme International Center. Anketimi në terren dhe analiza janë realizuar nga Applicative Research Solutions për EC Ma Ndryshe



## I. Hyrje

*“Qyteti i sotëm nuk është një rastësi. Forma e tij është e paqëllimshme por jo e rastësishme. Ajo është prodhim i vendimeve të marra për qëllime të veçanta, ndërveprimet e të cilave dhe efektet anësore nuk janë marrë në konsideratë. Projektimi i qyteteve është përcaktuar nga inxhinierë, gjeodetë, avokatë dhe investitorë, secili prej tyre duke marrë vendime të arsyeshme për qëllime të arsyeshme”, Jonathan Barnett (An Introduction to Urban Design)*

*“Qytetet tona mund të interpretohen si forma fizike të një lufte dinamike midis individuale dhe kolektive.” David Chipperfield (Bienalja e Venecias 2012)*

Sot në botë, transformimet bashkëkohore të qytetit janë shkakuar të ndërrimeve të thella të konturave të hapësirave publike dhe private. Këto ndërrime prodhojnë debat të gjallë në arkitekturë dhe urbanizëm në lidhje me transformimin e hapësirës publike: diskurse që zëshëm paralajmërojnë fundin e hapësirave publike<sup>1</sup>, duke treguar trendin në rritje të zëvendësimit të tyre me ambientet komerciale private; apo shkatërrimin e hapësirave publike të hapura për të gjithë, si pasojë e fushatës universale për ta rritur ndjenjën e sigurisë në qytete – hapësirave publike të mbikëqyruara me kamera sigurie dhe paralajmërojnë të siguruara - gated communities<sup>2</sup>; diskurse të tjera që marrin kahjen e avokimit të formave të reja të hapësirës publike për përdorim kolektiv duke u bazuar në urbanizmin e integruar, që duke i dhënë theks të veçantë proceseve, lëvizjeve, lidhshmërive, të papriturave dhe marrëdhënieve simbiotike ndërmjet njeriut dhe natyrës, ndërtesës dhe pejzazhit ka për qëllim të mbërrijë në zgjidhje të qëndrueshme

<sup>1</sup> Sorkin, Michael, ed. (1992). *Variations on a Theme Park: The New American City and the End of Public Space (hardcover)*. Hill & Wang

<sup>2</sup> Davis, Mike, ed (1992) *Beyond Blade Runner: Urban Control, The Ecology of Fear. Open Magazine Pamphlet Series; First Edition edition (1992)*

urbanistike, etj.<sup>3</sup>; strategjitë “njeriu parasëgjithash”, që vlerësojnë dhe dokumentojnë shkallën e “jetës në qytet” – të cilën mbi të gjitha duhet ftuar përmes dizanit të kujdesshëm të hapësirave publike. Kjo traditë mendimi sugjeron zgjidhje holisitike që energjizojnë dhe i shndërrojnë qytetet në ambiente të bukura dhe të shëndetshme, me hapësira publike tërheqëse dhe aktive, që në planin shoqëror promovojnë barazi dhe qëndrueshmëri<sup>4</sup>, etj.

Kohëve të fundit shtohen gjithnjë e më shumë shkrimet mbi konceptet e zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe tashmë ka marrë hov tradita e re e mendimit dhe praktikës së projektimit të qëndrueshëm urbanistik, që po reflektohet në masë të madhe edhe në zhvendosjen e agjendës së projektimit urbanistik drejt çështjeve më të zgjeruara të përgjegjësisë mjedisore. Dhe jo vetëm mjedisore. Me zhvillimin e qëndrueshëm në mendje, projektuesit njësoj duhet t’i kushtojnë rëndësi edhe impaktit shoqëror dhe zbatueshmërisë ekonomike afat-gjatë, si elemente që ndikojnë në formësimin e qyteteve sot. Koncepti në fjalë tashmë është normuar dhe bën pjesë në ligjet e shumë shteteve në botë.

Për të rrumbullakësuar atë që u tha deri këtu, mund të themi se qyteti i jep formë përditshmërisë sonë, përmes mundësive, kufizimeve dhe përvojave që i ofron. Ai përkufizon barrierat mendore e fizike dhe lidhshmëritë, dhe rrëfen tregimin mbi shoqërinë që e ka ndërtuar atë. Qyteti mirë e dizajnuar mbështet integrimin kulturor, promovon shëndetin, përforcon tregëtinë lokale dhe e lufton krimin.

<sup>3</sup> Ellin, Nan, ed.(2006) *Integral Urbanism, Routledge*

<sup>4</sup> Gehl, Jan, (2010) *Cities for People, ISLANDPRESS*

## II. Koncepti i qytetit gjithëpërfshirës

Për Ali Madanipour-in, qyteti “ofrohet dhe menaxhohet nga autoritetet publike”, dhe “shfrytëzohet dhe ndahet nga të gjithë anëtarët e bashkësisë”. Ai është “bota e përbashkët institucionale dhe materiale, hapësirë e ndërmjetme që lehtëson bashkëprezencën dhe rregullon marrëdhëniet ndërpersonale”.<sup>5</sup> Si hapësirë që ndahet barabartë nga të gjithë anëtarët e bashkësisë, dhe si produkt i demokracisë, qyteti poashtu përkufizon dhe shtron rregulla të mirësjelljes dhe respektit për tjetrin.

Konceptet e qëndrueshmërisë dhe gjithëpërfshirjes janë dy koncepte cilësore që shfrytëzohen shpesh në diskutet e fushës së planifikimit dhe zhvillimit. Programi i UN Habitatit e përkufizon qytetin gjithëpërfshirës si qytet që promovon zhvillimin me drejtësi. Qyteti gjithëpërfshirës “është vendi ku të gjithë, pavarësisht mundësive të tyre ekonomike, racës, gjinisë, etnisë apo fesë, mund të marrin pjesë plotësisht në të gjitha mundësitë shoqërore, ekonomike dhe politike që i ofron qyteti”. Sipas këtij programi drejtësia është një nga tri shtyllat e qëndrueshmërisë, dhe më e rëndësishmja që është thelbësore në krijimin e të ardhmës urbane të qëndrueshme dhe të përbashkët. (UN-Habitat, 2001)

Vizioni i qytetit gjithëpërfshirës përkthehet në ambient fizik përmes projektimit gjithëpërfshirës dhe planifikimit pjesëmarrës. Projektimi gjithëpërfshirës ua mundëson njerëzve nga grupe të ndryshme shoqërore dhe ekonomike që të marrin pjesë në hartim dhe të vlerësojnë projektet. Planifikimi pjesëmarrës është paradigmë e planifikimit urban që mëton përfshirjen e gjithë bashkësisë në proceset

strategjike dhe menaxhuese të planifikimit urban.

Qasja fillestare të projektimit gjithëpërfshirës është që të binden anëtarët e bashkësisë që të luajnë rol të rëndësishëm në hartimin e strategjive të herëshme dhe planifikimin e projekteve për qytetin e tyre. Me anë të përfshirjes së gjithë bashkësisë, problemet e vërteta, burimi i tyre dhe zgjidhjet potenciale parashtrihen dhe diskutohen në punëtori të ndryshme. Projektet dhe idetë që rrjedhin nga një punë e tillë me bashkësinë zakonisht janë të lidhura me kontekstin, dalin nga nevojat dhe kultura e bashkësisë dhe mjedisi në të cilin ato ekzistojnë. Falë pjesëmarrje të madhe, bashkësia do të kenë një sens të fortë pronësie dhe përkushtimi ndaj projektit.

Projektet e suksesshme janë të kënaqshme estetikisht dhe janë në harmoni me strukturën rrethuese të bashkësisë; njerëzit duan të jetojnë dhe punojnë në ato vende. Këto projekte ofrojnë ndjenjën e vendit me të cilin njerëzit identifikohen. Njerëzit do të kuptojnë projektin.

Në manualin “Qyteti gjithëpërfshirës” Goltsman and Iacofano e paraqesin planifikimin gjithëpërfshirës të qytetit si zgjidhje “të bazuar në politikat e ndjeshme ekonomike, shoqërore, mjedisore dhe kulturore që ua lejojnë të gjithëve të përmirësohen ekonomikisht bashkë me përmirësimin e hapësirës ku jetojnë”. Ata theksojnë se qytetet kanë nevojë për mënyrë planifikimi që e njeh të drejtën e përfshirjes të secilit njeri në proceset zhvillimore: “përmes pjesëmarrjes, njerëzit mund t’i japin formë mjedisit të tyre për t’i përmbushur nevojat e tyre.” Grupet me të prekura zakonisht rrallë përfshihen në proceset planifikuese meqë u mungojnë shkathtësitë, dija dhe informata. Kjo krijon pastaj rrezikun e mospërfshirjes së nevojave të tyre në planifikimin urban, që më tutje pasqyrohet me keqësimin e mjedisit të tyre

<sup>5</sup> Madanipour, Ali, (2003) *Public and Private Spaces of the City*, Routledge

jetësor. Për t'i adresuar këto problem, autorët e lartpërmendur sugjerojnë procesin e projektimit gjithëpërfshirës të bazuar në tri kategori: funksionalitet (projektim që ngërthen të gjithë tipet e individëve), ndjeshmëri kontekstuale (harmonia me mjedisin rrethues) dhe impakt të drejtësisë për të "zvogëluar impaktin shoqëror dhe njerëzor tek anëtarët më të prekur të shoqërisë".<sup>6</sup>

Për të përmbyllur atë që u tha deri më tash, gjatë planifikimit dhe projektimit të qyteteve duhet vënë theks të veçantë në zbutjen dhe përfundimisht zhdukjen e pabarazive që i kufizojnë dhe i përjashtojnë grupet e njerëzve, duke i penguar ata të bëjnë zgjedhjen e vendit dhe mënyrës së të jetuarit. Duhet penguar përjetësimin e pabarazive dhe duhet inkurajuar lidhjet shoqërore që përkufizojnë qytetet e gjallëruara dhe të lulëzuara.

---

<sup>6</sup> Goltsman, S, Iacofano, D, (2007), The Inclusive City: Innovative Solutions for Buildings, Neighborhoods, and Urban Spaces, MIG Communications).

### III. Projekti për planifikim me pjesëmarrje

“Qyteti gjithëpërfshirës – Planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren” është projekt tre-vjeçar i EC Ma Ndryshe, i cili synon të artikulojë nevojat e grupeve të komunitetit dhe t’i përkthejë ato në plane të zbatueshme urbane të komunës së Prizrenit. Projekti përkrahet nga Olof Palme International Center dhe ka filluar së zbatuari në muajin janar 2013. Grupet e komunitetit me të cilat po punohet në këtë projekt janë: gratë, të moshuarit, të rinjtë, personat me nevoja të veçanta, banorët e lagjeve të varfra, kultura dhe mjedisi. Me secilin grup të komunitetit, gjatë një viti të projektit organizohen katër fokus grupe dhe një debat publik, ndërsa paralelisht do të zhvillohet procesi i avokimit dhe bashkëpunimit me komunën e Prizrenit dhe Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor për të siguruar përfshirjen e kërkesave të qytetarëve në planifikimin urban të qytetit.

Planifikimi urban në Kosovë është një aktivitet teknik dhe i udhëhequr nga ekspertët, që kryesisht bazohet në të dhënat ekzistuese dhe ka pak ndërlidhje me mjedisin (kontekstin) për të cilin hartohet. Kjo praktikë kryesisht prodhon plane që janë jashtë kapacitetit realizues të qeverisë lokale dhe për më tepër, ajo nuk e reflekton realitetin në terren, me ç’rast qytetarët nuk kanë ndjenjë përkatësie. Pjesëmarrja e qytetarëve kufizohet brenda një periudhe të caktuar disa-ditore dhe kryesisht disa ditë para miratimit përfundimtar të planeve.

Ekziston një nevojë imanente për përfshirjen e interesave dhe aspiratave që qytetarëve në planet urbane, e sidomos të atyre grupeve që jetojnë janë të prvuara nga infrastruktura dhe shërbimet adekuate publike. Pjesëmarrja e gjerë e qytetarëve është qenësore që planet urbane të jenë relevante dhe të zbatueshme. Planifikimi

urban gjithëpërfshirës ndihmon edhe procesin e demokracisë lokale, duke inkurajuar përfshirjen qytetarë në të gjitha nivelet e procesit. Kjo qasje e re e urbanizmit (Urbanizmi i Ri) sfidon modelin aktual në Kosovë (planifikimin socialist të qyteteve), i cili ofron shumë pak hapësirë për qytetarin.

Projekti do të synojë përbushjen e këtyre objektivave specifike: [a] Të zhvillojë metodologji dhe qasje gjithëpërfshirëse në planifikimin urban, [b] Të sigurojë lidhjen e munguar mes qytetarëve dhe planerëve urban, [c] Të zhvillojë ndjenjën e përkatësisë së qytetarëve për mjedisin rrethues të jetesës, [d] Të përkthejë interesat dhe nevojat e qytetarëve në plane të zbatueshme urbane, [e] Të inkurajojë pjesëmarrjen aktive të grupeve të disfavorshme dhe të marginalizuara të shoqërisë, [f] Të promovojë qasjen e integruar të planifikimit urban (social, ekonomik, mjedisor dhe kulturor)

Kjo analizë përmblendhë të gjeturat dhe ofron rekomandime bazuar në anketën e parë të projektit me mostër të gjerë në Prizren. Deri tani, gjatë projektit janë realizuar: 28 fokus grupe me shtatë grupe të komunitetit, Tre aksione / performansa publike me qëllime avokimi (iniciativa komunitare), Memorandumi i Bashkëpunimit me Drejtorinë e Urbanizmit, dhe Anketimi me qytetarë të Prizrenit mbi planifikimin urban. Gjatë muajve shtator dhe tetor do të realizohen shtatë debate si dhe do të përgatiten raportet specifike për secilin grup të komunitetit. Në pjesën e fundit të vitit, këto raporte do t’i dorëzohen komunës së Prizrenit dhe do të fillojë faza e avokimit për përfshirjen e shqetësimeve dhe nevojave të qytetarëve në planet urbane të komunës.


#### IV. Metodologjia

Mostra për hulumtim është përzgjedhur në mënyrë të rastësishme duke përzgjedhur çdo të katërtën shtëpi. Fillimisht janë përcaktuar 12 vendnumrime në qytet nga të cilat vendnumrime janë përzgjedhur respondentët në mënyrë të rastësishme.

Rezultatet e hulumtimit janë të prezantuar në dy seksione njëra për mostrën e randomizuar në qytetin e Prizrenit dhe një me mostër të fokusuar me grupe të ndryshme të interesit.

Nga 249 të intervistuar, 57.8% (n=144) kanë qenë të gjinisë femrore dhe 42.2% kanë qenë të gjinisë mashkullore. Sa i përket moshës 24.5% të mostrës kanë qenë prej moshës 16-25 vjeçare, 67.7% të moshës 26-64% dhe 10.8% kanë qenë mbi moshën 65 vjeçare. 87.1% të mostrës ishin shqiptarë, 6.4% të komunitetit RAE, 3.6% turq dhe 2.8% kanë qenë bosnjak.

Figura - Statusi i punësimit



29.3% të intervistuarve kanë raportuar të jentë të punësuar, 23.3% janë amvise, 11.2% janë papunë që kërkojnë punë, 2% invalid, 10.4% pensionistë dhe 18.1% të jenë studentë osë mësojnë ndonjë zanat dhe 5.6 të papunë që nuk kërkojnë punë.

242 intervista janë zhvilluar më këto popullata: përfaqësues aktivistë të organizatave: rinore, përfaqësues të organizatave studentore, kulturës dhe trashëgimisë kulturore, shoqata të grave, gra të punësuar, amvise dhe të papunën,


shoqata të qytetarëve më nevoja të veçanta, përfaqësues të shkollave speciale, organizatat mjedisore, shoqatat sportive, shoqëritë kulturo artistike, qendrat për punës sociale, përfitues të skemave sociale dhe Kryqit të kuq të Kosovës, pensionistë dhe përfaqësues të shoqatave të pensionistëve, të pastrehë, banorë të lagjeve që nuk kanë kanalizim, të papunë të regjistruar në qendrën për punësim, nxënës të shkollave të mesme.

## V. Rezultatet

Seksioni i rezultateve është i organizuar sipas mostrës pjesa e parë paraqet rezultatet për mostrën e randomizuar dhe tjetra për mostrën me grupe të ndryshme të interesit


### Rezultatet për mostrën e randomizuar

Figura - A keni njohuri/informatë nëse qyteti i Prizrenit ka plan urban




62.7% të respondentëve kanë deklaruar se kanë njohuri/informatë se qyteti i Prizrenit ka plan urban.

Figura - Nga e keni marrë informatën mbi atë se Prizreni ka plan urban?



Nga 155 (62.2%) respondentë që kanë deklaruar se kanë njohuri për atë se Prizreni ka plan urban 69% kanë dëgjuar për planin urban nga mediet, 18.7% nga të afërmit dhe 12.3% nga të tjerët.


Figura - A keni informatë nëse qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve dhe rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin



$$\chi^2(1,249)=7.4, p<0.01$$

Mashkujt kanë raportuar se me përqindje më të lartë se kanë informatë se qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve dhe rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin me 50.5% ndërsa vetëm 1/3 e femrave kanë raportuar se kanë informatë për këtë çështje.


Figura - Mestarja e viteve të shkollimit në raport me nëse kanë se kanë informatë se qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve dhe rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin



Në mestare ata që kanë thënë se kanë informata se qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planve dhe rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin kanë mesatare më të lartë të viteve të shkollimit të përfunduar në krahasim me ata që nuk kanë dijeni për këtë mundësi.




Figura - Nëse kanë se kanë informatë se qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve dhe rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin në raport me etnicitetin



$$\chi^2 (3,249)=7.8, p<0.05$$

Shqipëtarët kanë raportuar në nivel më të lartë se kanë dijeni se qytetarët mund të marrin pjesë në diskutime publike të planeve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin në krahasim me etnicitetet e tjera.

Figura – Në se kanë marrë pjesë në debatet publike të organizuar nga komuna




Nga pëqindja e qytetarëve që kanë deklaruar se janë në dijeni se komuna organizon debate publike vetëm 7.6 të tyre kanë deklaruar se kanë marrë pjesë në ndonjërin prej tyre. Pesë respondentë kanë cekur edhe debatet në të cilat kanë marrë pjesë: për arsim, për planin urban, për rregullimin e lagjes, për rregullimin e rrugëve, për shtratin e lumit, për varrezat e reja dhe për planin rregullues.

Figura - Si i artikulonin nevojat e juaja në raport me organet komunale



Shumica e respondentëve apo 61% kanë thënë se personalisht kontaktojnë me organet komunale, 30% të respondentëve kanë deklaruar se nuk e dijnë se si mund ti artikulojnë nevojat e tyre dhe vetëm 6% kanë thënë se këtë e bëjnë përmes shoqatave dhe organizatave të ndryshme. Ndërsa forma të tjera të komunikimit me 3.6% kanë qenë përmes familjarëve, 4 kanë thënë se nuk komunikojnë fare për shkak të mungesës së besimit, organet gjyqësore, përmes kryetarit të lagjes, dhe peticionin.

Figura - A jeni ftuar në ndonjë debat publik nga organet komunale




Vetëm 15.7% të qytetarëve kanë deklaruar se kanë marrë ftesë nga organet komunale për debate publike për çështje të ndryshme të qytetit






Qytetarëve ju janë parashtruar 20 çështje të ndryshme të urbanizimit dhe të qytetit dhe ju është kërkuar që ata ti zgjedhin 4 çështje që duhet të kenë një adresim më serioz nga organet komunale. Analiza është bërë për të gjitha opcionet nëse është përmendur si çështje nga qytetarët e intervistuar. Si çështje që u përmend nga më shumë se gjysma e qytetarëve 63.1% ishte bllokimi i trotuareve me makina, e dyta ishte mungesa e mirëmbajtjes së trotuareve gjatë dimrit me 42.6%, 35% ndërtimet pa leje, mungesa e hapësirave të gjelbëruara 29% si e katërta, e pesta qarkullimi i vështirësuar për persona me aftësi të kufizuar, e gjashta problemet me ujësjellës dhe e shtata ndërtimet e larta.

Figura - Problemet kryesore të urbanizimit në qytet sipas qytetarëve mashkuj të Prizrenit



Si çështje që u përmend nga më shumë se gjysma e qytetarëve mashkuj ishte 59% ishte bllokimi i trotuareve me makina, e dyta ishte mungesa e mirëmbajtjes së trotuareve gjatë dimrit me 41.9%, 28.7% ndërtimet pa leje, mungesa e hapësirave të gjelbëruara 26.7% si e katërta, e pesta ujësjellësi, e gjashta ndërtimet e larta dhe e shtata mungesa e ndriçimit publik.


Figura - Problemet kryesore të urbanizimit në qytet sipas qytetarëve femra të Prizrenit



Si çështje që u përmend nga më shumë se gjysma e qytetarëve femra ishte 66% ishte bllokimi i trotuareve me makina, e dyta ishte mungesa e mirëmbajtjes së trotuareve gjatë dimrit me 43.1%, 30.6% ndërtimet pa leje, mungesa e hapësirave të gjelbëruara 30.6% si e katërta, e pesta problemet për qarkullimin e qytetarëve me nevoja të veçanta, e gjashta mungesa e çerdheve për fëmijë ujësjellësi dhe e shtata ujësjellësi.

12% e mostrës së përgjithshme ishin mbi moshën 65 vjeçare dhe këta respondentë përpos që ju janë përgjigjur pyetjeve që janë raportuar më lartë atyre ju është kërkuar që nga një grup i çështjeve urbanistike të zgjedhin 3 çështje kryesore që janë më relevante për këtë grup moshë.


Figura - Çështjet kryesore sipas pensionistëve në kuadër të mostrës së përgjithshme



80% të respondentëve mbi moshën 65 vjeçare mendon se mungon hapësirë e dedikuar për takimin e më të moshuarëve si çështje të parë, 50% bllokimin e trotuareve dhe me nga 30% është mirëmbajtja e trotuareve gjatë dimrit dhe ndërtimet pa leje.


57% e mostrës kanë qenë femra mbi moshën 16 vjeçare dhe në pyetjet e dedikuara për këtë mostër si çështje e parë është përmendur siguria në rrugë me 62%, e dyta bllokimi i trotuareve me makina 60% dhe me 35% mirëmbajtja e trotuareve gjatë dimrit.

Figura - Cështjet kryesore sipas femrave në kuadër të mostrës së përgjithshme me pyetje të veçanta për këtë popullatë



24.9% e mostrës kanë qenë të rinjë nën moshën 26 vjeçare, si tre çështje kryesore të zgjedhur nga të rinjtë janë si vijon në figurën e mëposhtme.


Figura - Cështjet kryesore sipas të rinjëve në kuadër të mostrës së përgjithshme me pyetje të veçanta për këtë popullatë



Si çështje kryesore që është përmendur janë mirëmbajtja e trotuareve gjatë dimrit, e dytë bllokimi i makinave me trotuare me 43.5% dhe e treta mungesa e hapësirave funksionale me teatër/kinema e përcjellur me të katërtën mungesën e hapësirave rekreative.

Një pyetje tjetër i ka pyetur të gjithë respondentët se sa janë të kënaqur me punën e komunës në çështje të caktuara dhe janë kërkuar të vlerësojnë prej 1 deri në 10. Më poshtë është paraqitur mesatarja e pikëve për secilën çështje. Pikët e ulëta paraqesin kënaqshmëri të ultë dhe pikët më të larta paraqesin kënaqshmëri më të lartë.

Figura - mesatarja e kënaqshmërisë prej 1-10 për çështje të ndryshme për gjithë mostrën




Niveli më i ultë i kënaqshmërisë është raportuar për atë se çka është brë për qarkullimin e personave me aftësi të kufizuar, e dyta për qarkullimin për këmbësorë, e treta për hapësirat kulturore, e katërta qytetarët nuk janë të kënaqur me atë që është bërë për ndërtimet pa leje dhe e pesta me mesatare më të ultë të kënaqësisë është raportuar për mirëmbajtjen e trotuareve gjatë dimrit.

Rezultatet për mostrën me grupe të interesit


Rezultatet e prezantuara janë të kategorizuar me organizatat për kulturë dhe trashëgimi kulturore, pensionistë, gra (të cilën pjesë e kanë plotësuar të gjithë respondentët e gjinisë femrore përpos përfaqësuesve të shoqatave të grave), të rinjtë, organizatat

Nga 242 respondentë përfaqësues të organizatave të ndryshme, përfitues të skemave sociale, të rinjë të punësuar dhe të papunësuar, gra të punësuar të papunësuar dhe pensionist ka rezultuar se pesë çështje kryesore për ta janë si vijon: bllokimi i trotuareve me makina 65.7%, 44.5% ndërtimet pa leje, 43% problemet e qarkullimit për persona me aftësi të kufizuar, me 38.4% mungesa e mirëmbajtjes së trotuareve gjatë dimrit dhe 29% ndërtimet e larta në qytet.


Figura – çështjet kryesore sipas respondentëve të organizatave të ndryshme, përfitues të skemave sociale, të rinj të punësuar dhe të papunësuar, gra të punësuar të papunësuar dhe pensionist



Në mostrën e dytë janë intervistuar 39 pensionistë dhe përfaqësues të shoqatës së pensionistëve dhe të gjeturat apo 5 çështje kryesore për ta janë: mungesa e vend takimit për pensionist/hapësira rekreative me 87.2%, bllokimi i trotuareve me makina 53.8%, mungesa e mirëmbajtjes së trotuareve gjatë dimrit me 35.9%, mungesa e parqeve publike me 25.8% dhe me 25.8% ndërtimet e larta në qytet.




Seksioni për çështjet kryesore për gra është plotësuar nga 147 respondentë që kanë qenë përfaqësues të organizatave të grave, pensionistë, amvise, gra që punojnë, student, gra pa punë, përfitues të skemave sociale etj. Si çështje më e shpeshtë e përmendur ka qenë siguria në rrugë prej 75.5% të grave, 54.4% kanë përmendur bllokimin e trotuareve me makina, 42.2% problemet e qarkullimit të personave me aftësi të kufizuar, 36.7% mungesa e mirëmbajtjes së trotuareve gjatë dimrit me 36.7% me 27.2% mungesa e çerdheve publike.



Rezultatet me organizatat kulturore

48 përfaqësues nga organizata kulturore apo që mirren më trashëgimi kulturore janë intervistuar (në disa organizata janë intervistuar më shumë se një anëtarë)




Katër çështje kryesore sipas përfaqësuesve të organizatave kulturore apo të çështjeve që mirren me trashëgimi kulturore e para ka qenë shkatërrimi i qendrës historike të qytetit të cilën e kanë futur në prioritete 79.2% e organizatave, pasuar nga ndotja e ajrit 54.2%, mungesë e një plani për zhvillim të qëndrueshëm për zhvillim mjedisor me 53.3%, problemet e qarkullimit për persona me aftësi të kufizuar me 43.8%.


Organizatat që punojnë me persona me nevoja të veçanta

në total 7 organizata janë intervistuar dhe problemet kryesore të raportuara nga këto organizata ka qenë si vijon 71.4% cekin se problem i rëndësishëm mungesa e qasjes së

personave me aftësi të kufizuar në transportin publik, 71.4% mungesa e pjerinave për qasje në institucione publike, me 42.9% mungesa e shenjzimeve për persona të verbër dhe e katërta bllokimi i trotuareve me 28.6%



47 të rinjë përfaqësues të organizatave rinore, të përfaqësuesëve të studentëve, të rinjë të punësuar dhe të papunësuar identifikohen këto si çështje kryesore: mungesa e hapësirave kulturore për koncerte dhe kinema 68.1%, mungesa e hapësirave rekreative 57.4%, problemet e qarkullimit për persona me aftësi të kufizuar 42.6% dhe bllokimi i trotuareve me makina 36.2%.





## VI. Konkludim

Rezultatet e mësipërme mund t'i përmbledhim në tri probleme kryesore të identifikuara nga qytetarët e Prizrenit:

**Informimi dhe pjesëmarrja qytetare** – Nga mostra e parë e hulumtimit, shihet që qytetarët e Prizrenit kanë njohuri për ekzistimin e planeve urbane, dhe për to informatat i marrin kryesisht prej mediave.

Diseminimi i informatave në lidhje me planet dhe strategjitë e zhvillimit të qytetit përmes mediave shpeshherë është i pamjaftueshëm dhe jo i plotë. Komuna duhet të insistojë në ndërmarrjen e fushatave vetëdijesuese dhe informuese përmes shpërndarjes së materialeve (posterë, fletushka, sms dhe emaila informues, etj.) dhe organizimit të takimeve informuese me fokus grupe në nivel të njësive më të vogla administrative (psh. këshillat e lagjeve, këshillat e banesave, etj.). Fokus grupet duhet të mbledhin grupe të ndryshme interesi, të moshave të ndryshme, pa anashkaluar fëmijët, rininë, pensionistët, gratë të punësuara dhe ato të papuna, bashkësitë tjera etnike, etj.

**Siguria e femrës dhe e drejta e barabartë për shfrytëzimin e qytetit** – Sipas hulumtimit del se femrat janë më pak të informuarat në lidhje me planet urbane dhe çështjet që ndërlidhen me qytetin në përgjithësi. Shqetësimi kryesor te planifikimi gjithëpërfshirës urban është e drejta e shfrytëzimit të barabartë të qytetit nga femra, pa pengesa, vështirësi dhe frikë. Siguria e femrës në qytet është objekt hulumtimi dhe trajtimi në disa publikime të agjensioneve ndërkombëtare (UN-Habitat), universiteteve në Evropë, Azi dhe Australi.<sup>7</sup>

Andaj, komuna duhet të fuqizojë rolin e femrës në proceset që ndërlidhen me planifikimin urban dhe të adresojë të gjitha aspektet që ndërlidhen me shfrytëzimin e papenguar të qytetit. Ajo duhet të insistojë që të takojë fokus grupe me përbërje femrash të të gjitha përgatitjeve shkollore, të punësuara dhe të papunësuara, qysh në fazat e herëshme të ndërtimit të vizionit dhe strategjisë për zhvillimin e ndonjë pjese të qytetit. Këto fokus grupe duhet të jenë shtyllë e rëndësishme e pjesëmarrjes qytetare në planifikimin e qytetit.

Qyteti gjithëpërfshirës promovon zhvillimin përmes pjesëmarrjes së barabartë, ku të gjithë pavarësisht racës etnisë, fesë e gjinisë fuqizohen dhe iu mundësohet që të marrin pjesë në mënyrë të plotë në planifikimin dhe vendim-marrjen. Një planifikim dhe qeverisje gjithëpërfshirëse do të ndikonte në: zvogëlimin e pabarazive dhe uljen e tensioneve sociale; inkorporimin e dijes, produktivitetit, kapitalit shoqëror dhe fizik të të varfërve dhe të të marginalizuarve në zhvillimin dhe planifikimin e qytetit.

Nga mostra e hulumtimit del se pjesëtarët e bashkësisë boshnjake, RAE dhe turke janë në disavantazh ndaj shumicës shqiptare në këtë aspekt. Shkalla e mosinformimit te këto bashkësi është jashtëzakonisht e lartë dhe mjaft shqetësuese. Nga këto të dhëna del se komuna duhet të angazhohet më shumë në sektorin e informimit në gjuhët e këtyre bashkësive, t'i takojë në fokus grupe të përziera dhe të veçanta si dhe duhet të punojë më shumë në integrimin e tyre dhe adresimin e shqetësimeve dhe çështjeve të interesit të tyre në lidhje me qytetin.

<sup>7</sup><http://www.femmesetvilles.org/index.php/en/publications> (qasur më 02.09.2013);

<http://www.abp.unimelb.edu.au/research/gender-inclusive-cities> (qasur më 02.09.2013);

**Shqetësimet e qytetarëve në lidhje me infrastrukturën urbane dhe aspektet e cilësisë së jetës në qytet** – Në mostrën e dytë të hulumtimit trajtohen më shumë çështje specifike infrastrukturore dhe të cilësisë së të jetuarit në qytet. Problemi më akut nga përgjigjet e të gjitha grupeve të interesit ndërlidhet me të qenit këmbësor dhe me lëvizjen e lirë në qytet. Pengesa në lëvizje nëpër trotore nga makinat e parkuara dhe në kushte të vështira atmosferike, nga bora e papastruar. Në grupin e problemeve të lëvizjes nëpër qytet hyjnë edhe problemet e mungesës së infrastrukturës së nevojshme për njerëzit me aftësi të kufizuara; problemet e sigurisë në rrugë, e cila edhe pse e pa specifikuar në pyetësor, mund të jetë siguria e lëvizjes e cënuar nga automjetet; siguria nga krimi; siguria e lëvizjes së femrës pa ngacmime e provokime të natyrës seksuale, etj.

Një nga trendet dominuese në projektimin urban të qyteteve qysh prej 30 vitesh, është promovimi i lëvizjes së lirë për këmbësorë dhe me biçikletë në gjithë qytetin, si dhe zvogëlimi i qarkullimit të automjeteve në qendra e zona të tjera që janë më të përshtatshme për mbledhjen e njerëzve. Shembull i një zhvillimi të tillë të qytetit është Kopenhaga, e cila përmes iniciativës së urbanistit Jan Gehl, qysh në fund të viteve të '70 nisi largimin e qarkullimit të automjeteve në qendër si dhe promovoi lëvizjen me biçikletë. Këtë do të mund ta bënte edhe komuna e Prizrenit në bashkëpunim me qytetarët.

Shqetësimi tjetër që dominon ndër qytetarë të Prizrenit, bazuar në këtë hulumtim, është hapësira dhe objektet publike. Grupi i interesit të pensionistëve prej problemeve kyçe në qytet, cilëson mungesën e vendtakimit të tyre si dhe mungesën e parqeve. Ndërsa të rinjtë në vend të parë kanë mungesën e hapësirave dhe objekteve për aktivitete kulturore. Komuna e

Prizrenit, krahas promovimit të lëvizjes në qytet në këmbë dhe me biçikletë, dhe zgjerimit të rrjetit të rrugëve dhe shtigjeve këmbësorike, do të duhej të kujdesej për krijimin e pikëtakimeve, hapësirave publike të madhësive të ndryshme, parqeve e zonave të gjelbëruara dhe hapësirave për kulturë e rekreacion. Këto të gjitha janë edhe aspekte të domosdoshme të një qyteti të qëndrueshëm. Çuditërisht, për qytetarët e Prizrenit, një nga pyetjet më pak shqetësuese, del se është transporti publik. Kjo lë të nënkuptohet se shumë nga ta për relacione të shkurtëra dhe të gjata përbrenda qytetit përdorin automjetet personale. Në një qytet me popullësi prej 177 mijë banorësh është më se i nevojshëm një rrjet i zgjeruar i transportit publik, që do të mundësonte udhëtime të shkurtëra por edhe vajtje-ardhje nga fshatrat fqinje për në qytet. Komuna do të mund të ndërmerre hapa për vendosjen e një rrjeti të tillë, me autobusë dhe minibusë që do të përdornin 'energji të gjelbër' dhe që do të lironin trotuarët dhe rrugët nga makinat e parkuara, dhe njëkohësisht do të ndikonin në lehtësimin e njerit prej shqetësimeve të mëdha të qytetarëve të Prizrenit, ndotjen e ajrit.

Përfundim: Të promovosh gjithëpërfshirjen në qytet nuk është vetëm çështje e drejtësisë shoqërore, por edhe çështje qendrore e zhvillimit të qëndrueshëm urban. Planifikimi pjesëmarrës ndihmon në gjetjen e zgjidhjeve që mund të integrohen në projektet zhvillimore urbane dhe që i adresojnë problemet dhe shqetësimet e të gjithëve dhe me këtë do të përmirësojnë qeverisjen urbane. Gjatë planifikimit gjithëpërfshirës, puna me grupet e ndryshme të interesit nxjerr mekanizma dhe prodhon mjete që zgjidhin probleme brenda komunitare, të cilat pastaj lehtë mund të adaptohen për t'u funksionalizuar dhe zbatuar në projekte konkrete urbane.



## EC Ma Ndryshe

Organizata jo-qeveritare “Emancipimi Civil Ma Ndryshe” u themelua në mars të vitit 2006. Qëllimet kryesore të organizatës janë: promovimi i qytetarisë aktive dhe pjesëmarrëse dhe ngritja e vetëdijes qytetare për mbrojtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore. EC Ma Ndryshe është ndër themelueset dhe përfaqëson Kosovën në Rrjetin e Evropës Juglindore të organizatave që merren me trashëgimi kulturore – SEE Heritage Network. Gjithashtu, është themeluese e Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, Rrjetit të Organizatave Kulturore të Prizrenit dhe Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës në Kosovë – Forumi Kulturor. EC Ma Ndryshe, që nga themelimi më 2006 është duke ushtruar presion direkt ndaj qeverisë lokale në Prizrenit për të krijuar qasje shoqërisë civile dhe qytetarëve për bashkë vendimmarrje. Përveç pjesëmarrjes direkte në proceset e konsultimeve publike, EC Ma Ndryshe ka avokuar rregullisht për respektimin e obligimeve ligjore për konsultime publike, përfshirjen sa më të gjerë komunitare në konsultime publike dhe përfshirjen e shqetësimeve dhe kërkesave të komunitetit në dokumentet e politikave publike.

*Projektet kryesore:* Urbanism Watch – urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm (2013 – 2015), Pjesëmarrja qytetare përmes medias sociale në Prizren dhe Gjiilan (2013 – 2014), Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren (2013 – 2015), Trashëgimia kulturore, shtyllë qendrore për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe rajonal në Prizren (2013 – 2014), Vullnetarët e Kulturës (2012 – 2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore në komunën e Prizrenit (2012 – 2013), Transparenca online e komunës së Prizrenit dhe Mamushës (2012 – 2014), Roli i shoqërisë civile në promovimin e trashëgimisë kulturore (projekt rajonal) 2011 – 2013, Një përrallë ballkanike, trashëgimia otomane në Ballkan (projekt rajonal) (2011 – 2013), Ngritja e vetëdijes kulturore tek të rinjtë përmes dokumentarëve (2010), Forcimi i veprimit qytetar për promovim dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore (2009), Platforma “Culture 2013” (2008 – 2009), Kampet e Restaurimit (2007, 2008 & 2009), Forumet e Hapura Qytetare (2007), Ditët e Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2006, 2007 & 2008), Zambaku i Prizrenit 2006.

*Publikimet:* Kush mbikëqyr mbikëqyrësit – Ilogaridhënia e shoqërisë civile në Kosovë (2013), Rinia dhe Transparenca – të përjashtuar apo të injoruar? (2013), Planifikim urban për qytetarët (2013), “Prizreni qytet kulturor”, film dokumentar (2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin e politikave kulturore në Prizren (2013), Gabim pas gabimi – analizë mbi gabimet e panumërta dhe të vazhdueshme në trashëgimi kulturore (2013), Katër analiza të projektit “Online Trasparenca”: 1. Degradimi Natyror dhe Urbanistik, 2. Respektimi i ligjit në qeverisjen lokale, 3. Qeverisja e mirë nuk është fjalë goje, 4. Transparenca e qeverisjes lokale në Prizren (2012 – 2013), Silent Balkan, film dokumentar i projektit “A Balkan Tale” (2012), Jeta kulturore në komunën e Prizrenit (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2010-2011), Prizreni në Retrovizore, krahasim i fotografive të vjetra dhe të reja të Prizrenit (2009), Vullnetarizmi dhe Trashëgimia Kulturore (2009), Intervenimi me kosto të ultë (2009), Dokument Strategjik mbi Organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2008), Trashëgimia Kulturore dhe Turizmi Kulturor në Prizren (2008), Hapësirat Kulturore në Kosovë (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2008).